



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
MINISTRI

Nr. 2459 Prot.

Tiranë, më 15.03 2016

**URDHËR**

Nr. 110, datë 15.03.2016

**PËR**

**FILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR DHE DATËN E ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE  
PËR AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË  
ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit Nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 131 të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Fillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, në datën 16.03.2016.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, të jetë më datë 20.04.2016.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

